



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 2306/1 prot.

Tiranë, më 13 / 10 /2025

URDHËR

Nr. 94, datë 13.10.2025

“PËR FILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR DHE CAKTIMIN E DATËS SË ZHVILLIMIT TË ZGJEDHJEVE PËR KOMISIONIN E PËRHERSHËM PËR DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR” NË NIVEL NJËSIE KRYESORE, NË TË 3 (TRI) NJËSITË KRYESORE TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”

Në bazë të nenit 39, 46 e vijues të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 28, 29, 32, 35 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme” në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, të Urdhrit të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë nr. 93, datë 13.10.2025 “Për përcaktimin e kritereve që duhet të plotësojnë dhe dokumentacionin që duhet të dorëzojnë kandidatët për anëtar të Komisionit të Përhershëm për dhënie e gradës shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” si dhe afatit të përfundimit të mandatit të komisioneve të përhershme për dhënie e gradës shkencore “Doktor” në njësitë kryesore të UMT-së,

URDHËROJ:

1. Fillimin e procesit zgjedhor për Komisionin e Përhershëm për Dhënie e Gradës Shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore në UMT, në datë 17.10.2025.
2. Votimi për Komisionin e Përhershëm për Dhënie e Gradës Shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore në UMT, do të zhvillohet më **19.11.2025**.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ), njësitë kryesore dhe Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

REKTORI
Prof. Dr. XHELADIN DRAÇINI